



P1.Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

"Qeverisja lokale bazohet në parimet si: sundimi i ligjit, përgjegjësia, llogaridhënia, besimi, transparenca, efektiviteti, efikasiteti, partneriteti dhe koherenca."

Përmbajtja

P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1. F1. Administrata vendore	4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	5
3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2	7
3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2	10
3.1.4. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O3.	12
4. Buxheti i programit të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)	12
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim);	14

P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

1. Hyrje

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

2. Politikat e zhvillimit

Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore: Pjesëmarrja, Sundimi i Ligjit, Transparenca, Përgjegjshmëria, Konsensusi, Barazia, Efektiviteti dhe Eficienca, Llogaridhënia dhe Vizioni Strategjik.

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlidhet dhe me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, e cila do të zbatohet nga administrata e Bashkisë së Shkodrës do të jenë:

I. Struktura menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

III. Dixhitalizmi i administratës publike do të jetë gjithmonë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër dhe përmes web-it për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Shkodrës.

3. Funksionet:

3.1. F1. Administrata vendore

F1.O1 Burime Njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017


- Një strukturë hierarkike funksionale në përmbushje të kompetencave dhe funksioneve ligjore, përmbushjes së misionit të Bashkisë Shkodër;
- Qeverisja Vendore në Bashkinë Shkodër e mirë në të katër treguesit: Efektiviteti & Efienca, Llogaridhënia, Transparenca & Sundimi i Ligjit dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve.
- Menaxhimi Financiar shumë i mirë në të gjitha hallkat përbërëse të tij;
- Vendimmarrja e Informuar e mirë , përdorim i mirë i platformës GIS; sistem raportimi i mirë i Bashkisë Shkodër.
- Performanca e mirë e bashkisë në bashkëpunimet e saj me donatorët, komunitetin apo institucionet ndërkombëtare, duke e karakterizuar atë si një bashkëpunim produktiv.
- Sistemi i buxhetimit me pjesëmarrje është vlerësuar shumë mirë, përkundër vlerësimit mesatar të strukturave të lindura nga iniciativat e qytetarëve në Shkodër.
- Ekzistenca e një platforme efektive dialogu që siguron përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes është vlerësuar e mirë.
- Llogaridhënia ka marrë vlerësim të mirë si kriter i qeverisjes vendore të Bashkisë Shkodër. Mekanizmat e kontrollit janë vlerësuar të mira. Vlerësimin më të lartë, si shumë të mirë e ka marrë ndjekja e rekomandimeve të KLSH-së.
- Komunikimi dhe reagimi në Bashkinë Shkodër na paraqitet si i mirë.
- Përgjigjshmëria e administratës vendore raportohet me një vlerësim total shumë të mirë, ku përgjigjshmëria e kërkesave të komunitetit dhe mesatarja e ankesave të trajtuara plotësisht na paraqiten si shumë të mira.
- Reagimin e pushtetit vendor ndaj ankesave është vlerësuar mesatar, arsye kjo edhe e përqindjes së ulët të qytetarëve të cilët edhe pse kanë patur arsye, nuk kanë paraqitur një ankesë në Bashkinë Shkodër.
- Pozicionimi i Bashkisë Shkodër për të gjitha kriteret e vlerësuara është më i lartë se mesatarja e 61 Bashkive.
- Mbështetje e strukturës funksionale me 367 punonjës nga këto: 1 i zgjedhur, 15 të emëruar politikë, 24 punonjës të policisë bashkiake, 15 punonjës të njësive së menaxhimit të qendrave komunitare, 12 punonjës IMT, 201 nëpunës civilë dhe 99 punonjës mbështetës dhe administrativë;
- Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
- Plotësim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve: : personel i ri i rekrutuar (23 punonjës me status të nepunesit civil, 23 punonjës mbështetës dhe administrativ ,1 ankesë gjate procesit te rekrutimit nder 23 procese rekrutimi, 5 ankesa per lirim nga detyra, nga këto 3 procese të fituara nga Bashkia, 2 në proces);

– Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimit të punonjësve në përputhje me ligjin në fuqi . Një shërbim civil i qëndrueshëm, profesional dhe eficient. Janë realizuar 86 trajnime për punonjësit me status nëpunësi civil; nga këto 50 punonjës me status nëpunësi civil të trajnuar ; dhe 36 punonjës të trajnuar sipas fushave përkatëse 5 punonjes mbi menaxhimin e sistemit të planifikimit vendor ne nivel vendor,3 punonjes te trajnuar mbi trajnimi e vijueshem profesional te audituesve te brendshem , 5 punonjes mbi bilancin e pergjithshem gjinor ne institucionet lokale., 2 punonjes mbi ndotjet detare dhe hidrokarburet ,4 punonjes mbi administrimin e pyjeve dhe kullotave, 2 punonjës mbi procedurat e VNM /VSM ,bazat ligjore dhe rolin e pjesëmarrjes se publikut, 2 punonjëse mbi sherbimet aftercare, 2 punonjës mbi financat vendore 5 punonjës mbi standartizimin e informacionit turistik dhe krijimin e një platforme marketingu të territorit. Gjithashtu janë zhvilluar trajnime teknike ne fushën TIK per stafin TIK (6 specialiste) të institucionit në programet: Bazë të Dhënash, Rrjete Kompjuterike dhe Smart Processes.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Një strukturë hierarkike funksionale në përmbushje të kompetencave dhe funksioneve ligjore, përmbushjes së misionit të Bashkisë Shkodër; Mbështetje e strukturës funksionale me 367 punonjës nga këto: 1 i zgjedhur, 15 të emëruar politikë, 24 punonjës të policisë bashkiake,15 punonjës të njësisë së menaxhimit të qendrave komunitare, 12 punonjës IMT, 201 nëpunës civilë dhe 99 punonjës mbështetës dhe administrativë; Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë. Plotesim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.		

3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P1.F1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	205,096	233,674	238,344
P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	150	150	200
P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	200	200	300



3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

F1.O2. Sigurimi i Shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017

- Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si (ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, etj.
- Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike, dhe paisje të tjera shtesë)
- Shërbim mbrojtje nga zjarri për 60 ambjente .
- Përmirësim i kushteve optimale për stafin në ushtrimin e kompetencave të Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative si furnizimi me kancelari, letër, bojëra për printera e fotokopje, shtypshkrime, fotokopjime A0 etj për 16 drejtori , 10 Njësi dhe 5 Lagje .
- Pajisje zyre funksionale për përmbushje të kushteve fizike optimale për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme për 16 drejtori , 10 Njësi Administrative dhe 5 Lagje
- Sigurimi i ambjenteve të punës sipas standarteve higjieno – sanitare në funksion të një performance sa më të lartë dhe përmirësimin e kushteve të punës në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje.
- Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake për 24 punonjës policie
- Përcaktimi i nevojave emergjente të mjeteve për riparim dhe realizimi i shërbimit për riparimin, blerjen e pjesëve të ndërrimit për këto mjete, me qëllim monitorimin, zbatimin e projekteve dhe mbikqyrjen e shërbimeve .
- Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës, furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave.
- Garantim i shërbimeve të pritje- përcjelljeve për 150 persona.
- Rritje e standartit të plotësisht të kushteve të punës ndaj administratës për rimbursimin e shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon
- Sigurimi i 10 ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.
- Ndërtesa administrative funksionale dhe në shërbim të administratës vendore : mirembajtja objekte për 4 zyra (100 m²), llyerje me boje 2000m² në godina qendër dhe NjA.
- Komunikim Elektronik Web Based: 21 njësi me shërbim interneti (bashkia Qendër, 10 Nj.Administrative , 5 Lagje, 5 Qendra Komunitare) , 6 Sisteme Informacioni Web Based
- Shërbime Administrative Elektronike: 83 shërbime të konfiguruar në SiZ1N 25000 kërkesa për shërbime përmes SiZ1N në vitin 2017 dhe 16 Njësi Administrative ofrojnë shërbimet përmes SiZ1N.
- Shërbime Financiare Elektronike Vendore: 9932 Subjekte (Biznese) të regjistruar në SiTTV me të dhënat dhe selitë përkatëse dhe të faturuar sipas viteve fiskale , 4910 Individë (Familjarë) të faturuar në SiTTV, 25000 kërkesa nga SiZ1N të kontrolluara për shlyerjen e detyrimeve dhe të faturuara për tarifat e shërbimeve përkatëse nga SiTTV si rezultat i integritetit të dy platformave online.
- Infrastrukturë Fizike (Hardware) TIK: 32 komponente pajisjesh multifunksionale të mirembajtura, 32 pajisje TIK të reja të prokuruar
- Shërbime interaktive të ofruara përmes faqes zyrtare të internetit: 8 module për ndërveprim online me qytetarët

- Buxheti me pjesëmarrje: 13 programe buxhetore , gjeolokalizim i investimeve dhe shërbimeve ndaj komunitetit -Open Data (regjistri i prokurimeve të investimeve /shërbimeve) - ndërveprim online me qytetarët (sugjerime online) -llogaritje automatike e detyrimeve vendore vjetore te individëve / bizneseve.
- Shlyerja e detyrimeve për ndjekjen dhe përfaqësimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit si dhe shlyerja e detyrimeve që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Realizimi i shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore 17 çështje të cilat janë në procese gjyqësore, 11 detyrime të ardhura nga zyrat përmbartimore 2 detyrime që rrjedh nga masa administrative me gjobë
- Shpenzime gjyqësore për ngritjen e kërkesë padive në lidhje me vlerën e debitorëve në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në zonat /ndërtimet informale
- Mbledhja e detyrimeve të lëna rekomandim nga KLSH si dhe detyrime të subjekteve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara nga Aluizni.
- Sigurimi i një shërbimi cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara.
- Mbrojtja e interesave të përbashkëta të Bashkive të Shqipërisë, me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendor dhe garantimi i pagesës së kuotizacionit vjetor nga buxheti i bashkisë.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Vazhdimi i përmirësimit të funksionimit normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë.		
Krijim i kushteve optimale për stafin në ushtrimin e kompetencave të Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative		
Mjete transporti funksionale për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave		
Të garantohen shërbimet e pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve dhe pranimit të ftesave për bashkëpunim me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.		
Rimbursimi i udhëtimeve dhe dietave i administratës vendore në lëvizje për arsye pune brenda dhe jashte vendit		
Pajisje zyre të vlefshme për përmbushje të kushteve fizike optimale për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër		
Sigurimi i funksionimit të 10 ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.		
Përmirësim i kushteve në ndërtesat administrative funksionale dhe në shërbim të administratës vendore		
Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i përmirësuar në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Posttribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).		
Aplikim, marrje e Certifikatave të pronësisë për pronat të Bashkisë së Shkodrës		
Shërbim Internetit i integruar në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet dhe 5 Qendrat Komunitare).		
Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i përmirësuar në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Posttribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).		

Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në Bashkinë Shkodër për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore i aksesueshëm përmes disa kanalesh, pajisjesh dhe formash të komunikimit elektronik

Infrastrukturë pajisjesh TIK të mirëmbajtura dhe të reja në shërbim të administratës vendore.

Portal zyrtar interneti i strukturuar, informues gjithnjë drejt e-shërbimeve dhe të dhënave të hapura (Open Data), i aksesueshëm përmes disa kanalesh, pajisjesh dhe formash të komunikimit elektronik

Realizimi i shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore

Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore pbledhjen e të arhurave vendore në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Postrribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).

Krijimi i kushteve me qëllim që të ushtrohen funksionet në shërbim të transportit të stafit

Sigurim dhe rinovim i mjeteve të punës për punonjësit e shërbimeve mbështetëse

Portal zyrtar interneti i strukturuar, informues gjithnjë drejt e-shërbimeve dhe të dhënave të hapura (Open Data), i aksesueshëm përmes disa kanalesh, pajisjesh dhe formash të komunikimit elektronik

Sistemi i integruar funksional për menaxhimin dhe komunikimin e dokumentacionit bazuar në detyrat dhe funksionet e administratës publike përmes platformave të përpunimit të dokumentacionit zyrtar në internet.

Implementimi i sistemit të vëzhgimit në 10 Njësitë Administrative dhe 5 Lagjet, të interuar me Bgrashkinë Qendër

Implementimi i sistemit të regjistrimit Video FULL HD në mbledhjet dhe aktivitetet e Sallës së Këshillit të Bashkisë Shkodër

Ofrimi i shërbimeve administrative me SiZ1N dhe i tarifave dhe taksave vendore me SiTTV përmes portalit zyrtar të internetit të Bashkisë Shkodër, portalit e-Albania si dhe të aksesueshëm përmes disa kanalesh, pajisjesh dhe formash të komunikimit elektronik

Menaxhim elektronik i bazës së të dhënave të shtresave në nevojë përmes një sistemi informacioni për shërbimet sociale

Implementimi i sistemit të përkthimit simultan në mbledhjet dhe aktivitetet e Këshillit të Bashkisë Shkodër

Aksesim elektronik i informacionit zyrtar dhe shërbimeve vendore elektronike, përmes kanaleve inovative të komunikimit elektronik të instaluar në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër

Implementim i sistemit të informacionit GIS i integruar i të dhënave vendore si: SiZ1N, SiTTV, baza të dhënash shtetërore RKGJC, QKB, etj.

Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor dhe të shpejtë ndaj komunitetit për funksionet e deleguara

3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	6,810	6,910	6,940
P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	9,500	9,500	10,700
P1.F1.O2.A3 Shërbim higjeno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	300	300	400
P1.F1.O2.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)	1,000	1,000	1,200
P1.F1.O2.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës	4,610	4,610	4,610
P1.F1.O2.A6 Organizimi i pritjeve të perfaqesuesve të institucioneve vendase dhe të huaja .	1,400	1,500	1,500
P1.F1.O2.A7 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë	300	300	300
P1.F1.O2.A8 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	800	843	1,000
P1.F1.O2.A9 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës.	800	800	800
P1.F1.O2.A10 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	700	700	1,000
P1.F1.O2.A12 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	500	500	800
P1.F1.O2.A13 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër	2,500	2,500	2,200
P1.F1.O2.A14 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	2,100	2,100	2,184
P1.F1.O2.A15 Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise)	710	710	710
P1.F1.O2.A16 Informimi i qytetareve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër	76	-	-
P1.F1.O2.A17 Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV)	550	550	550
P1 F1 O2 A18 Upgrade-im i SiTTV (Sistemi i Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore) në Mobile App dhe mirëmbajtje, për ofrimin e shërbimeve të taksave dhe tarifave vendore përmes smartphone ndaj biznese dhe qytetarëve	-	980	128
P1.F1.O2.A19 Mirëmbajtje 3-vjeçare Pajisje Informatike	306	312	318
P1.F1.O2.A 20 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	5,000	6,000	6,000
P1.F1.O2.A21 Mirëmbajtje 3-vjeçare e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300	300	300
P1.F1.O2.A22 Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App dhe mirëmbajtje	980	128	128
P1.F1.O2.A23 Detyrime dhe kompensime legale	-	7,316	7,316

P1.F1.O2.A25 Rikonstrukcion kati perdhe, ish Hotel Sporti Shkoder	5,744	-	-
P1.F1.O2.A26 Blerje automjete në funksion të administratës	4,000	2,000	2,000
P1.F1.O2.A27 Blerje vegla pune	-	-	300
P1.F1.O2.A29 Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendëruar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud.	-	5,000	-
P1.F1.O2.A30 Sistemi i Vëzhgimit i 15 Njësive Administrative me Bashkinë Qendër	3,000	-	-
P1.F1.O2.A31 Sistemi i Akses Kontrollit i 15 Njësive Administrative me Bashkinë Qendër	-	3,000	-
P1.F1.O2.A32 Sistem Regjistrimi Video Full HD për Sallën e Këshillit të Bashkisë	800	-	-
P1.F1.O2.A33 Upgrade-im dhe mirëmbajtje për ofrimin e shërbimeve administrative përmes SiZ1N dhe taksave e tarifave vendore SITTV permes faqes zyrtare webtë Bashkisë Shkodër dhe portalit e-Albania	5,000	650	650
P1.F1.O2.A34 Upgrade-im i SiZ1N (Sistemi i Integruar të Zyrave me Një Ndalesë) në Mobile App dhe mirëmbajtje, për ofrimin e shërbimeve administrative smartphone ndaj qytetarëve	-	980	128
P1.F1.O2.A35 Upgrade-im i funksionaliteteve dhe mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale	1,500	564	564
P1.F1.O2.A36 Ndërtimi i Bazës së të Dhënave të Monitorimit të Shërbimit të Pastrimit	675	-	-
P1.F1.O2.A38 Sistem Informacioni GIS i të dhënave vendore dhe i integruar me sistemet e tjera të informacionit si SiZ1N, SITTV, Sistemin e Informacionit të Shërbimeve Sociale, etj...	-	-	15,000
P1.F1.O2.A39 Sistem i perkthimit simultan në Sallën e Këshillit të Bashkisë	-	1,880	-
P1.F1.O2.A40 Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative) & shpenzimet per zgjedhjet	18,234	18,585	18,944

F1.03 Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.

Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017

- Realizimi i shpërblimit mujor për anëtarët e e këshillir bashkiak dhe kryetaret e fshatrave të Njësive Administrative së Bashkisë Shkodër sistematikisht dhe me korrektësi për çdo muaj.

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

Situata e synuar 2020

Mbështetje për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi për 51 anëtarët këshillit vendor dhe 92 kryetaret e fshatrave të Nj A.

3.1.4. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O3.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P1.F1.O3.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepaletë)	16,653	16,986	17,327
P1.F1.O3.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqiperise	500	500	500
P1.F1.O3.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut	10,000		

4. Buxhetimi i programit të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim), për v.2018 planifikohet buxheti me vlerë totale 310,794 mijë lekë ndër të cilat 72 % paga dhe sigurime shoqërore, 16 % shpenzime operative, transfertat 3 % dhe 9 % investime.


Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim), për v.2019 planifikohet buxheti me vlerë totale 332,028 mijë lekë ndër të cilat 75.8 % paga dhe sigurime shoqërore, 17.9% shpenzime operative dhe 6.3 % investime.

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim),për v.2020 planifikohet buxheti me vlerë totale 343,341 mijë lekë ndër të cilat 74.8 % paga dhe sigurime shoqërore, 18.1 % shpenzime operative dhe 7.1 % investime.

Tabelë 1 Planifikimi për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Programi P1	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2017	234,051	53,099	730	29,210	317,090
Plani 2018	222,452	50,838	10,680	26,824	310,794
Plani 2019	251,381	59,284	680	20,683	332,028
Plani 2020	256,410	61,951	680	24,300	343,341

Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)



5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim);

Nr. 1	Projekti: P1.F1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	Llojet e programit: P1. Administrim, Menaxhim, Planikim Funksioni: P1. F1 Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Paga dhe shtesat mbi paga Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016” Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Me shkresën nr.16267 prot. dt.07.12.2016 i është kërkuar Prefektit informacion mbi caktimin e grupit të njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page që bëhet nga Prefekti mbi bazën e numrit të banorëve të regjistrit të gjendjes civile në fillim të çdo viti dhe në bazë të shkresës nr.76 prot, dt.17.01.2017 është bërë planifikimi i pagave për vitin 2017. Me VKB nr.7 ,dt 30.01.2017 “ Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar ,të nëpunësve civilë e punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë për v.2017” është miratuar struktura nga Kryetaria e Bashkisë dhe në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM-ve në zbatim të tij janë zhvilluar procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil” sipas afateve ligjore dhe procedurave të konkurimit për vendet vakante. Planifikimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2017 ishte në shumen 233 701 mijë lekë, pasi planifikimi ishte bërë duke u bazuar në shtesën prej 10%, që është deklaruar nga qeveria, në prezantimin e projektbuxhetit të shtetit për vitin 2017. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 8.3.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 datë 02.03.2016” Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.dhe VKM Nr. 717, datë 23.6.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" i ndryshuar, shtesa nuk u realizua në masën 10%. Duke qenë se ka fond të papërdorur nga viti 2017, nga plani i parashikuar në shumën prej 233 701 mijë lekë , i pritshmi i vitit 2017 është në shumën prej 209 701 mijë lekë, në planin e vitit 2018 do të paraqitet për diferencë një vlerë prej 24 000 lekë ne zerin paga. Struktura e Bashkisë Shkodrës përfshin 367 punonjës të administratës së Bashkisë së Shkodrës, nga këto : 1 i zgjedhur, 15 të emëruar politikë, 24 punonjës policia bashkiake, 15 punonjës njësia e menaxhimit të qendrave komunitare, 12 punonjës IMT, 201 nëpunës civilë dhe 99 punonjës mbështetës dhe administrativë. - Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. - Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12. 1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit		
ii. Synimi i projektit		
Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore: Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve për administratën vendore.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën vendore.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfutësve të synuar)		
Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.		

c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Drejtoria e Financës 3. Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qender			Bashkia e Shkodrës				
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018			Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferi me
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	175 591	175 591				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	29 325		29 325			
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180	
	Shuma	205 096	175 591	29 325		180	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019			Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferi me
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	200 080	200 080				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	33 414		33 414			
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180	
	Shuma	233 674	200 080	33 414		180	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020			Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferi me
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	204 082	204 082				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	34 082		34 082			
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180	
	Shuma	238 344	204 082	34 082		180	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2018, 2019, 2020			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Drejtoria e Finances 2.Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder				

Nr.2	Projekti: P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	Llojet e programit: P1. Administrim, Menaxhim, Planikim Funksioni: P1. F1 Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Një ndër detyrat më të rëndësishme të programit Adminstrim, Menaxhim dhe Planifikim ishte plotësimi i strukturës organizative me staf të kualifikuar dhe përmbushjes së detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune. Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive . Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgorinë egzekutive". Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, janë paguar në vlerën 10.000 0 lekë për çdo procedurë konkurimi. Anëtarët e KPLP dhe KPND , janë paguar në vlerën 5.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Këto shpenzime janë përballuar nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime. Në bazë të planit vjetor për vitin 2017, janë realizuar procedura për pranim në shërbim civil të grupuara sipas pozicioneve dhe procedura për ngritje në detyrë. Procedura e pranimit në kategorinë ekzekutive u realizua nepermjet konkurimit te hapur i cili u zhvillua ne dy faza. Kjo procedure u ndoq fillimisht me plotesimin e vendeve te lira ne kategorine ekzekutive nga nepuneit civil me proceduren e levizjes paralele.Ne përfundim të kesaj procedure pa asnjë të përzgjedhur, u ndoq procedura nëpërmjet konkurimit te hapur. Procedura e ngritjes në detyre u realizua nepermjet konkurimit te hapur për kategorine e ulët dhe te mesme drejtuese Vendet e lira u plotësuan sipas nenit 25 te ligjit nr.152 date 01.10.2013 "Për nëpunësin civil" .Personel i ri i rekrutuar 23 punonjës.		
ii. Synimi i projektit		
- Vazhdim i përmirësimit të qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore. - Rekrutimi i Administratës Vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në kohë, në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve në fuqi duke garantuar plotësimin e standarteve në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe në bazë të planit vjetor të rekrutimeve .		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
• Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin n vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit. • Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune) • Hartimi i dokumentacionit përkatës • Ngritja e Komisioneve të Pranimit sipas rasteve • Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të interneti t të Bashkisë Shkodër • Zhvillimi i procedurave të testimit. • Emërimet		
b) Rezultatet e pritshme		
Në zbatim të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgorinë ekzekutive".,VKM nr. 108 dt. 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimeve nëshërbimin civil" , Njesia e Burimeve Njerëzore përgatit planin vjetor të pranimeve për vitin pasardhës .Ky planifikimin vjetor për pranimin në shërbimin civil, përfshin: • Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil; • Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil; • Ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në pikën "1" dhe "2". Në baze të planifikimit vjetor për rastet e daljeve ne pension, pë lirime nga detyra etj planifikohen 5 procedura pranimi në detyrë, dhe 5 procedura ngritje në detyrë.Kjo procedurë konkurimi zhvillohet në disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre janë ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 1 52/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, paguhen në vlerën 10.000 lekë për çdo procedurë konkurimi pë pranim në shërbimin civil dhe 5 000 mije lekë për procedurën e ngritjes në detyrë .Fondi për mbulimin e shpenzimeve të anëtarëve të KPP –së përballohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qender			Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse					
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.		150			150		
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)							
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës							
A.4	Ngritja e Komisioneve te Pranimit sipas rasteve							
A.5	Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër							
A.6	Zhvillimi i procedurave te testimit							
A.7	Emërimet							
	Shuma		150			150		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë vitit 2018								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.		150			150		
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)							
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës							
A.4	Ngritja e Komisioneve te Pranimit sipas rasteve							
A.5	Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër							
A.6	Zhvillimi i procedurave te testimit							
A.7	Emërimet							
	Shuma		150			150		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë vitit 2019			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse					

Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sig uri me	Ope rativ e	Tra nsfe rime	Kap itale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në standat për njoftime publike të institucionit.	200			200		
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)						
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës						
A.4	Ngritja e Komisioneve të Pranimit sipas rasteve						
A.5	Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në standat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër						
A.6	Zhvillimi i procedurave të testimit						
A.7	Emërimet						
	Shuma	200			200		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë vitit 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder					

Nr.3		Projekti: P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës		Llojet e programit: P1. Planifikim, Manaxhim, Administrim		Funksioni: P1.F1 Administrata Vendore	
a) Përshkrim i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Nëpunësit civilë trajnohen në kuadrin e përgjithshëm të programeve të trajnimit, të organizuara nga institucioni në përputhje me programet e përgjithshme të trajnimit. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativë të tij, por vetëm për detyrën që ai kryen, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit . Trajnimi bëhet sipas planit të zbatimit të projektit të miratuar nga bashkia dhe asistimi i vazhdueshëm gjatë periudhës së implementimit. Kuadri i trainimeve për punonjësit e qeverisjes vendore hartohet ne Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), e cila njihet me ligj, si autoriteti i vetëm për dhënien e trainimeve të njohura dhe të çertifikuara, për këtë grup. Të gjitha veprimtaritë trajnuese për njësitë e qeverisjes vendore duhet të kalojnë përmes ASPA. Për vitin 2017 jane realizuar 86 trajnime për punonjësit me status nëpunësi civil; nga këto 50 punonjës me status nëpunësi civil të trajnuar nga ASPA për punonjësit në periudhe prove ; dhe 36 punonjës të trajnuar sipas fushave përkatëse 5 punonjes mbi menaxhimin e sistemit të planifikimit vendor ne nivel vendor,3 punonjes te trajnuar mbi trajnimi e vijueshem profesional te audituesve te brendshem , 5 punonjes mbi bilancin e pergjithshem gjinor në institucionet lokale., 2 punonjes mbi ndotjet detare dhe hidrokarburet ,4 punonjës mbi administrimin e pyjeve dhe kullotave, 2 punonjës mbi procedurat e VNM /VSM ,bazat ligjore dhe rolin e pjesemarrjes se publikut, 2 punonjës mbi shërbimet aftercare, 2 punonjës mbi financat vendore 5 punonjes mbi standartizimin e informacionit turistik dhe krijimin e nje platforme marketingu te territorit Stafi TIK në Bashkinë Shkodër ka realizuar disa trajnime teknike në fushen e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit të domosdoshme për mirëmenaxhimin e punës së përditshme të pajisjeve Hardware dhe Sistemeve të Informacioneve të implementuara. Trajnime të tilla do të ndikojnë në përmirësimin e punës së tyre për të cilën janë përgjegjës, në përmirësimin e punës së administratës vendore dhe më së shumti në përmirësimin e qeverisjes elektronike të institucionit tonë. Është planifikuar që të realizohen deri në fund të vitit trajnime mbi: Menaxhim të Bazave të të Dhënave, Admnsitrim të rrjeteve elektronike, Ëindoës Server Active Directory, menaxhim i platformave Microsoft Office 365 që do të ndihmojë administratën vendore që të bëjnë një manaxhim më të suksesshëm të dokumentave zyrtar të mënyrë të qendëruar, bazuar edhe në komhnikim me internet, dhe do t'i ofrojë një punë më profesionale dhe të personalizuar institucionit të Bashkisë. Për përdorimin e platformës Microsoft Office 365 do të jetë i nevojshëm edhe një trajnim për administratën vendore.							
ii. Synimi i projektit							
Të krijojë vazhdimësi profesionale në administratën publike. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimit të punonjësve në përputhje me ligjin në fuqi.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
1. Analiza, vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim të nëpunësve të Bashkisë Shkodër. 2.Vlerësimi i rezultateve në punë pas verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. 3 Identifikimi i nevojave. 4.Trajnimet e stafit të ri dhe ekzistues të bashkisë dhe të niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj.							
b) Rezultatet e pritshme							
Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në funksion të rritjes së vazhdueshme profesionale për përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve. Krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.							
1. Identifikimi i kërkesave për uniforma 2. Përgatitja e dokumentacionit për prokurim në zbatim të ligjit 3. Zbatimi i procesit (blerja e uniformave)					
b) Rezultatet e pritshme					
Përmirësimi i imazhit të Policisë së Bashkisë					
c) Aktoret e mundshme		d) Kontributet e mundshme në projekt			
1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Policia Bashkiake 3. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qender		Bashkia Shkoder			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	Kapitale
A.1	Identifikimi i kërkesave për uniforma				
A.2	Procedurat administrative të tenderimit etj.				
A.3	Blerje uniforma	500		500	
Shuma		500		500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	Kapitale
A.1	Identifikimi i kërkesave për uniforma				
A.2	Procedurat administrative të tenderimit etj.				
A.3	Blerje uniforma	500		500	
Shuma		500		500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	Kapitale
A.1	Identifikimi i kërkesave për uniforma				
A.2	Procedurat administrative të tenderimit etj.				
A.3	Blerje uniforma	800		800	
Shuma		800		800	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			

Gjatë vitit, 2018, 2019, 2020

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
 2. Policia Bashkiake
- Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder



Nr. 15	P1.F1.O2.A13 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit: P1. Planifikim, Menaxhim, Administrim Funksioni:P1.F1. Administrata Vendore				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Ky projekt synon përbushjen e detyrimeve që Bashkia Shkodër ka për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 421, datë 02.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare(të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës" , Vendim të Këshillit të Ministrave me nr. 433, datë 3.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish – Komunave /bashkive. VKM Nr. 477, datë 29.06.20011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Postribë, të Qarkut të Shkodrës,VKM Nr. 1088, datë 23.7.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Gur i Zi, të Qarkut të Shkodrës", VKM nr. 944, datë 17.11.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dajç, të Qarkut të Shkodrës. Pjesë shumë e rëndësishme e zbatimit të këtij projekti janë edhe prona të tjera që fitohen nga shpronësimet. Janë planifikuar për tu dërguar për regjistrim 250 prona Aktualisht janë ridërguar në ZVRPP Shkodër për regjistrim 40 prona në zbatim të VKM-së nr. 421, datë 02.06.2010 dhe 317 prona pyje e kullota të ekonomisë pyjore kullimore Rosek Drisht ne zbatim te VKM-së nr. 433, datë 3.6.2016. Në zbatim të VKM-së nr. 623 datë 24.9.2014 "Për Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve "Ali Spahija", "Nexhip Luli", "Bujar Bishanaku", "Stacioni i Trenit", "Rruga e Kalasë", si dhe Sistemitimi i bllokut të pallateve, "Qafë-Hardhi", të Bashkisë së Shkodrës janë dërguar për rregjistrim 3 prona të cilët plotësojnë dokumentacionin per regjistrim. Nga ana e ZVRPP Shkoder eshte rregjistruar vetëm prona e fituar me shpronësimin e kryer në Sistemitimi i bllokut të pallateve "Qafe Hardhi". Sasia totale e pronave te dërguar per regjistrim eshte 357 prona . ZVRPP Shkoder per pronat e dërguara në zbatim të VKM-së nr. 433, datë 3.6.2016 nuk bën aplikimin mbasi nuk zotëron harta për këto zona pyje dhe kullota. Sasia totale e pronave qe duhet te dërgohen per regjistrim ne zbatim te VKM-se 421. date 2.06.2010 eshte 73 prona dhe 69 prona qe do te ridërgohen per regjistrim ne total 142 prona me vlerë 142*7000 leke/prone= 994 000 leke Numri i pasurive qe duhet te dërgohen per regjistrim te transferuara me VKM-ne nr. 477, datw 29.06.2011, VKM-ne nr. 1088, datw 23.7.2008, VKM-ne nr. 944, datw 17.11.2010 70*7000 =490 000 leke Numri i pasurive që duhet të dërgohen për regjistrim në zbatim të VKM-së nr. 433, date datë 3.6.2016, është 2080 pasuri me vlere 2080*7000= 14 560 000leke Numri i pronave që fitohen nga shpronësimet 30 prona *7000 leke = 210 000 leke Për të zbatuar VKM-te e sipërcituara nevojitet një vlere prej 16,254,000 leke						
ii. Synimi i projektit						
Të përmirësojë qeverisjen lokale në funksion të ofrimit të shërbimeve sipas standarteve të parashikuara ndaj komunitetit. Të dergoje për regjistrim të gjitha pronat e transferuara me VKM .						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Përgatitja e dokumentacionit për regjistrim për secilen pronë 2. Dërgimi i dokumentacionit për aplikim në ZVRPP Shkodër për regjistrim						
b) Rezultatet që prisni						
Çertifikatat e pronësisë për pronat e transferuara në pronësi nga Vendimet e Këshillit të ministrave, duke përbush detyrimet ligjore Çertifikata e pronësisë për pronat e përfituara nga shpronësimet , të cilët bëjnë të mundur likuidimin e vlerës së shpronësimi it dhe kryerjes se detyrimeve ndaj ligjit dhe qytetarëve.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria juridike dhe menaxhimit te aseteve dhe aksioneve te ndërmarrjeve/ Drejtoria e Finances. Drejtoria e Burimeve Njerezore Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qender			Bashkia Shkodër.			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferim e	Kapitale

A.1	Rregjistrim prona të paluajtshme	2500			2500		
	Shuma	2500			2500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Rregjistrim prona të paluajtshme	2500			2500		
	Shuma	2500			2500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Rregjistrim prona të paluajtshme	2200			2200		
	Shuma	2200			2200		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2018, 2019,2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Juridike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Aksioneve të Ndermarrjeve Drejtoria e Finances. Drejtoria e Burimeve Njerezore Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder					

Nr. 16	P1.F1.02.A14 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Bashkia Shkodër merr shërbimin e internetit sipas dispozitave ligjore në fuqi, të komunikimit elektronik të përcaktuara nga AKSHI. Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendëruar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implentuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Arkitektura e komunikimit siguron një linjë back up emergjente për të gjitha linjat e komunikimit. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndhmës Ekonomike, Sistemi i Dixhitalizimit të Arkivave, e-Lejet, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al , menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj.							
ii. Synimi i projektit							
Synohet ofrimi i shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagjet dhe Qendrat Komunitare të saj, në përputhje me standartet e përcaktuara për komunikimin elektronik.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Ofrimi i shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër. - Ofrimi i shërbimit të internetit në 10 Njësitë Administrative: Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Posttribë, Pult, Rrethi na, Shalë, Shosh dhe Velipojë. - Ofrimi i shërbimit të internetit në 5 Lagjet: 1, 2, 3, 4 dhe 5, - Ofrimi i shërbimit të internetit në Qendrat Komunitare.							
b) Rezultatet që prisni							
- Duhet të vazhdojë të funksionojë sistemi i ofrimit të shërbimit i qendëruar dhe i menaxhueshëm nga Bashkia Qendër. Zgjidhja e implentuar duhet të ofrojë 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. - Paketa nuk duhet të shfaqë një vonesë me të madhe se 110 ms bazuar në madhësinë minimale të një pakete standarde prej 32 bytes. - Numri i paketave të humbura (në %) që nuk arrijnë në destinacion me të vogël se 3 (tre). - Arkitektura e komunikimit duhet të sigurojë një linjë back up emergjente për të gjitha linjat e komunikimit. Sistemi do të sigurojë konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. - Ofruesi i shërbimit nuk duhet të shohë, përdorë ose bëjë publike tek palë të treta infomacionin e transmetuar në linjat e komunikimit. - Të gjithë njësitë e bashkisë Shkodër do të kenë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim rrit shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ul kostot operative, rrit transparencën dhe gjurmon informacionin. - Ky shërbim garanton mirëfunksionimin e sistemeve të informacionit bazuar në platforma web dhe komunikim të brendshëm (intranet) që bashkia që bashkia ka nënë në funksion, që është në fazë shtrirje dhe implementimi sistemesh të reja, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Informacionit të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndhmës Ekonomike, Sistemi i Dixhitalizimit të Arkivave, e-Lejet, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë shërbimin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) - Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qender				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Shërbimi internetit në Bashkinë Qendër	475			475		
A.2	Shërbimi internetit në 5 Lagjet						

A.3	Shërbimi internetit në 10 Njësité Administrative dhe Qendrat Komunitare	1625			1625		
	Shuma	2100			2100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi internetit në Bashkinë Qendër	475			475		
A.2	Shërbimi internetit në 5 Lagjet						
A.3	Shërbimi internetit në 10 Njësité Administrative dhe Qendrat Komunitare	1625			1667		
	Shuma	2100			2142		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi internetit në Bashkinë Qendër	475			475		
A.2	Shërbimi internetit në 5 Lagjet						
A.3	Shërbimi internetit në 10 Njësité Administrative dhe Qendrat Komunitare	1709			1709		
	Shuma	2184			2184		
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder					

Nr. 17	P1.F1.O2.A 15 Mirëmbajtje 3-vjecare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N-Smart Processes Enterprise)	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Në vitin 2017 Bashkia ka përfundura shtrirjen e Sistemit të Integruar të Zyrove me Një Ndalesë në të gjitha Njësitë Administrative dhe në zbatim të marrëveshjes Nr. 7975 Datë 24.06.2016të nënshkruar me Programin për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) janë investuar licencat për shtrirjen e këtij sistemi informacioni gjithashtu në 5 Lagjet. Bashkia Shkodër përmes buxhetit të vitit 2017 ka investuar pajisjet TIK për 5 Lagjet për të mundësuar ofrimin e shërbimeve administrative elektronike SiZ1N duke filluar nga muaji Janr 2018. Gjatë vitit 2017 raportohen nga sistemi 25000 kërkesa për shërbime administrative elektronike të procesuara në ciklin e plotë të rrjedhës së tyre të punës. Për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e këtij sistemi edhe në të ardhmen, Bashkia Shkodër në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e implemetnimit të sistemeve të informacioneve të miratuara nga AKSHI, duhet të sigurojë mirëmbajtjen e licensave të sistemit në një periudhë minimalisht 3-vjeçare.		
ii. Synimi i projektit		
Ofrimi i shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër 2. Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për 5 Lagjet 10 Njesitë Adminsitative		
b) Rezultatet që prisni		
Sistem i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i qëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarit dhe biznesit pavarësisht së ku ndodhet. Të gjithë shërbimet administrative do të ofrohen në zbatim të Rregullores së Ofrimit të Shërbimeve Adminsitative të miratuar nga kryetari i Bashkisë në zbatim të një rrjedhe pune të mirëpërcaktuar, mbështetur në skedën e secilit shërbim dhe brenda afati ligjor të parashikuar të tyre. Shërbimet duhet të ofrohen në bashkinë Qendër, në të gjitha Njësitë Administrative dhe në Lagjet e Bashkisë Shkodër. Ky sistem informacioni bazohet në platformë web, dhe si i tillë garanton reduktim të kohës dhe koston së shërbimeve, rrit transparencën, profesionalizmin, cilësinë, korrektësinë dhe luftën kundër korrupsionit.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë • Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë licencat e zgjerimit të sistemit, asistencën teknike për mirëmbajtje(sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) dhe trajnimet e stafëve sipas nevojës. • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër		Bashkia Shkodër
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mije lekë)
A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër	245
A.2	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	465
	Shuma	710
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)
		Nga kjo:
	Paga	Sigurime
	Operativ e	Transferi me
	Kapitale	

A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër	245			245		
A.2	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	465			465		
	Shuma	710			710		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër	245			245		
A.2	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	465			465		
	Shuma	710			710		
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder					

Nr.18	P1.F1.O2.A16 Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit “qytetari në qendër” ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes Zyrrave të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në bashkinë Qendër, në të gjitha njësitet administrative dhe së fundmi është në proces shtrirja e sistemit në 5 Lagjet e qytetit. Në këto zyra ofrohen 83 shërbime administrative përmes një sistemi informatik të bazuar në një platformë eeb i cili menaxhon shërbimet e kërkuara nga qytetarët, pavarësisht se në cilën zyrë qytetari bën kërkesën, në formën e një rasti të mirëfilltë për procesim (case) duke e përcjellë atë elektronikisht me dokumentacionin përkatës bashkëlidhur, sipas një rrjedhe punë (workflow) të miratuar dhe të automatizuar. Në vitin 2017 rezultojnë 25000 kërkesa për shërbime të regjistruara dhe të ofruara përmes këtij sistemi informatik ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Shkodrës. Implementimi i këtij projekti është mbështetur financiarisht nga Qeveria Zvicerrane dhe përkatësisht nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp). Mbështetja është realizuar në investime hardware dhe software duke siguruar infrastrukturën e përshtatshme për qendrueshmërinë e tij në bashkinë Qendër, njësi administrative dhe lagje. Përmes marrëveshjes nr. 9376Prot datë 27.10.2015 të nënshkruar, dldp ka financuar blerje pajisjesh TIK të nevojshme për zyrën me një ndalesë të bashkisë Qendër dhe përmes marrëveshjes nr. 7975Prot datë 24.06.2016 të nënshkruar, dldp ka financuar infrastrukturën fizike të ndërtimit të rrjetit të komunikimit elektronik (intranet) në 5 njësi administrative: Ana e Malit, Bërdicë, Guri i Zi, Postrribë dhe Rrethina. Procedurat e prokurimit janë kryer dhe janë ndjekur nga bashkia Shkodër duke rezultuar në një tepëricë totale prej 76,796 lekësh. Në zbatim të marrëveshjeve, tepëricat nuk i kthehen donatorit, por duhet të përdoren deri në shpenzimin përfundimtar të tyre për të njëjtin qëllim. Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht u është prezantuar qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrat me Një Ndalesë. Por njëkohësisht vlerësojmë informimin e qytetarëve për këto shërbime, dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një njet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar-qeverisje vendore.		
ii. Synimi i projektit		
Informimi dhe përfshirja publikut, një mjet i sigurtë për qeverisje të mirë.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Implementimi i informacionit për publikim viziv (video, reklame, spot) - Identifikimi i mediave vizive lokale dhe kostove përkatëse për publikim të informacionit - Nënshkrimi i marrëdhënies kontraktuale - Publikimi i informacionit (video, reklame, spot)		
b) Rezultatet që prisni		
Informimi i qytetarëve për Zyrat me Një Ndalesë më të afërta të bashkisë Shkodër, për listën e shërbimeve administrative dhe përfitueshmërinë e tyre.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider), mediat vizive lokale - Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër		DLDP (tepricat nga investimi i Blerje Pajisje TIK dhe Ndertimi i Intranet në Një për Zi1N))
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Nga kjo:
	Totali (mijë lekë)	Paga
		Siguri me
		Operative
		Transfere
		Kapitale
A.1	Publikimi i spotit televiziv ne mediat vizive lokale	76
	Shuma	76
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder

Nr. 19	P1.F1.O2.A17 Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV)	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Në vitin 2017 Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni (SiTTV) për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore bazuar në Paketën Fiskale në fuqi. Ngritja dhe implementimi i këtij sistemi informacioni është bërë mbi një platformë web bazuar në menaxhimin e proceseve të punës të Drejtorisë së Planifikimit dhe Regjistrimit të të Ardhurave Vendore. Karakteristikë e rëndësishme e këtij sistemi është integrimi me SiZ1N për shërbimet administrative që i ofrohen qytetarit dhe e biznesit, kundrejt tarifave të miratuara në dokumentin e Paketës Fiskale. Përmes këtij sistemi informacioni është bërë e mundur: 1. Dokumenti i Paktës Fiskale 2. Qasja e përdoruesve në program 3. Autentikimi i përdoruesve në programin e taksave dhe tarifave vendore 4. Autorizimi i përdoruesve në programin e taksave dhe tarifave vendore 5. Regjistrimi i Bizneseve 6. Llogaritja automatike e detyrimeve dhe gjenerimi i njoftimeve 7. Gjenerimi automatik i faturave 8. Regjistrimi i pagesave 9. Raportet 10. Faturat për Individet 11. Verifikimi automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore në SiZ1N 12. Faturimi i shërbimeve të SiZ1N direkt nga SiTTV dhe printimi i tyre nga sportelet e Zi1N Sistemi është i integruar dhe funksional në Bashkinë Qendër dhe Njësitë e saj Administrative. Për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e këtij sistemi edhe në të ardhmen, Bashkia Shkodër në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e implementimit të sistemeve të informacioneve të miratuara nga AKSHI, duhet të sigurojë mirëmbajtjen e licencave të sistemit në një periudhë minimalisht 3-vjeçare.		
ii. Synimi i projektit		
Ofrimi i shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Mirëmbajtje e Licencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative të saj		
b) Rezultatet që prisni		
Sistem i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore i konsoliduar për mbledhjen e të ardhurave vendore nga Drejtoria e Planifikimit dhe Regjistrimit të të Ardhurave, ndaj biznesit, individit familjar dhe institucioneve, pavarësisht vendndodhjes së tyre në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative. Ky sistem do të jetë një ndërfaqe komunikuese dhe mbështetëse e ofrimit të shërbimeve administrative përmes SiZ1N. Përmes këtij sistemi do të mund të gjurmohet në mënyrë elektronike: 1. Dokumenti i Paketës Fiskale 2. Qasja e përdoruesve në program 3. Autentikimi i përdoruesve në programin e taksave dhe tarifave vendore 4. Autorizimi i përdoruesve në programin e taksave dhe tarifave vendore 5. Regjistrimi i Bizneseve 6. Llogaritja automatike e detyrimeve dhe gjenerimi i njoftimeve 7. Gjenerimi automatik i faturave 8. Regjistrimi i pagesave 9. Raportet 10. Faturat për Individet 11. Verifikimi automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore në SiZ1N 12. Faturimi i shërbimeve të SiZ1N direkt nga SiTTV dhe printimi i tyre nga sportelet e Zi1N Ky sistem garanton reduktim të kohës dhe kostos së shërbimeve, rrit transparencën, profesionalizmin, cilësinë, korrektësinë, luftën kundër korrupsionit dhe mbi të gjitha garanton një proces të besueshëm të mbledhjes së të ardhurave të institucionit tonë në kohën e duhur dhe në masë realizimi më të madhe.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) asistencën teknike për mirëmbajtje (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit).		Bashkia Shkodër

• Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qender						
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Mirëmbajtje e Liçencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative të saj	550			550	
	Shuma	550			550	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Mirëmbajtje e Liçencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative të saj	550			550	
	Shuma	550			550	
Shpenzimet për çdo aktivitet 20120		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Mirëmbajtje e Liçencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative të saj	550			550	
	Shuma	550			550	
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder				

Nr. 20		P1.F1.O2.A19 Mirëmbajtje Pajisje Informatike		Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë kësaj periudhe është bërë vazhdimisht një rivlerësim i pajisjeve egzistuese TIK në bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj, janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë për dorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderushme e këtyre pajisjeve i është kryer shërbimi i mirëmbajtjes. Ndërkohë duhet theksuar se nevoja e mirëmbajtjes së pajisjeve është e vazhdueshme dhe duhet të parashikohet çdo vit. Disa pajisje TIK, kryesisht pajisje multifunksionale printer/skaner/fotokopje në varësi të karakteristikave dhe specifikimeve teknike që mbartin e kanë të nevojshme përsëritjen e mirëmbajtjes së tyre në intervale të caktuara kohore.							
ii. Synimi i projektit							
Mbështetje e administratës vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Identifikimi i pajisjeve informatike që kanë nevojë për mirëmbajtje teknike, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut.							
b) Rezultatet që prisni							
Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në përputhje me kapacitetet minimale teknike në mbështetje të punë së administratës vendore.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë mirëmbajtjen (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit). - Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	306			306		
Shuma		306			306		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	312			312		
Shuma		312			312		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	318			318		
Shuma		318			318		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar 2018 – Dhjetor 2020		Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder					

Nr. 21	P1.F1.O2.A20 Blerje Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë kësaj periudhe është bërë një rivlerësim i pajisjeve egzistuese TIK në bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj, janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderueshme të këtyre pajisjeve i është kryer shërbimi i mirëmbajtjes. Pajisje të reja TIK janë prokuruar nga bashkia gjatë këtij viti, ndërkohë që nevoja për ripërtëritje të pajisjeve egzistuese TIK është tejte e nevojshme dhe do të bëhet gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI-t për Komunikimet Elektronik, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.						
ii. Synimi i projektit						
Mbështetje e administratës vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Identifikimi i nevojës për pajisjeve TIK, llojit dhe sasisë së tyre, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme bazuar në rregulloren e specifikimeve teknike që AKSHI do të miratohet për vitin 2018 dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut.						
b) Rezultatet që prisni						
Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punë së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë pajisjet. - Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transferim e
A.1	Identifikimi i nevojës për pajisjeve TIK, specifikimi dhe preventivimi	5000				5000
	Shuma	5000				5000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferim e
A.1	Identifikimi i nevojës për pajisjeve TIK, specifikimi dhe preventivimi	6000				6000
	Shuma	6000				6000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transferim e
A.1	Identifikimi i nevojës për pajisjeve TIK, specifikimi dhe preventivimi	6000				6000
	Shuma	6000				6000

f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder
--	---

Nr. 22	P1.F1.O2.A21 Mirëmbajtje 3-vjecare e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër zotëron faqen zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 on-line dhe aktualisht është një faqe e nivelit të III^{le} në përputhje me rregulloren e AKSHI-t për faqet zyrtare në administratën publike. Faqja është e ndërtuar mbi platformën web easyweb 2.0, një sistem i menaxhueshëm nga përdoruesit e bashkisë në nivel përmbajtjeje. Ofruesi i këtij shërbimi është përgjegjësi për host-imin, mirëmbajtjen teknike dhe ofrimin e shërbimit të adresave e-mail të stafit nën domain-in zyrtar. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që bashkia të ndajë me qytetarët të gjithë projekt-vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e-Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e bashkisë. Moduli i SiZIN, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar on-line. Shkarkimi i formularëve on-line, informacioni i detajuar i regjistratës të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparenca e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portali web. Aktualisht faqja zyrtare e internetit e Bashkisë Shkodër është e një niveli të lartë informimi dhe përfshirëse e qytetarëve, e vlerësuar me çmimin eparë në vitin 2017 në kuadër të transparencës për zbatimin e të drejtës për informim ndër 61 bashkitë e vendit tonë.		
ii. Synimi i projektit		
Synohet ofrimi i shërbimeve elektronike, forcimi i komunikimit virtual, llogaridhënës dhe transparent Bashki – Qytetar, Bashki-Biznes dhe anasjelltas (G2C / C2G, G2B / B2G).		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Hostimi i Aplikimit 2. Suport 3. Shërbimi e-mail 4. Moduli i Librisë Ligjore 5. Moduli i Forumit on-line 6. Formulari on-line për raportimet e qytetarëve		
b) Rezultatet që prisni		
Bashkia Shkodër do të zotërojë një faqe gjithnjë e më ndërpërdorues me vizitorin (user-friendly) të strukturuar në mënyrën e duhur të tillë që informacioni i kërkuar të jetë i kapshëm në të shumtën 3 klikime. Do të ofrojë një qeverisje të hapur dhe transparente ndaj qytetarit dhe biznesit, duke bërë publike çdo vendim të institucionit, çdo investim të detajuar dhe me gjeoreferencë të lokalizuar, çdo të ardhur që mbledh, çdo shërbim që ofron, konsultim të detyrimeve vendore familjare dhe të biznesit, çdo informacion të saj direkt nga ky portal web. Do të konsultohet në mënyrë elektronike (virtuale) me qytetarin/biznesin përmes e-pjesëmarrjes në sondazhe apo publikime për të cilat kërkohet një konsultim virtual. Do t'i japë mundësi vizitorit të faqes të mund të komunikojë në një forum on-line apo të raportojë problematika të ndryshme përmes formularëve on-line. Përmes platformës së integruar Transparenca e Buxhetit do të gjurmojë bashkinë dhe administratën e saj në zbatimin e politikave fiskale dhe realizimit të investimeve dhe shërbimeve e planifikuara në çdo vit. Ky portal do të jetë mjeti që do të rris transparençën, luftën kundër korrupsionit, korrektësinë dhe cilësinë e punës së administratës vendore të institucionit.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë • Komunikimi me Median • Drejtoritë përgjegjëse për përpunimin e informacionit për publikim në web sipas specifikave përkatëse. • Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë host-imin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) si dhe trajnimet e stafëve sipas nevojës. • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qender		Bashkia Shkodër
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018	Totali	Nga kjo:

		(mije lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
			Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder				

Nr. 23	P1.F1.O2.A22 Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App dhe mirëmbajtja	Llojet e programit: P1. Planifikim Menaxhim Administrim Funksioni: P1.F1. Administrata Vendore					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Në vitin 2017, Bashkia Shkodër me mbështetjen e Qeverisë Zvicerrane përmes Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), në mbështetje të nismës së saj të vazhdueshme të buxhetimit me pjesëmarrjen e qytetarëve, ka implementuar një instrument inovativ on-line për informimin e publikut për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve. Ky instrument është quajtur Transaprenca e Buxhetit. Një instrument i tillë, Open Data, është prezantuar për herë të parë në Shqipëri, i realizuar për herë të parë nga Bashkia Shkodër, në muajin mars të vitit 2017, duke bërë publike çdo të dhënë mbi çdo të ardhur në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, çdo shpenzim apo investim të bërë sipas programeve buxhetore (vlera të parashikuara, vlera të realizuara, datë fillimi dhe mbarimi e shërbimit/investimit, operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit, foto ilustruese pas përfundimit dhe dorëzimit të shërbimit apo investimit, mundësinë e marrjes së sugjerimeve nga qytetarët) për çdo vit kalendarik. Instrumenti ofron një modul tjetër të rëndësishëm për llogaritjen vjetore të taksave dhe tarifave për secilin prej nesh, i programuar në zbatim të dokumetit të Paketës Fiskale. Çdo e dhënë e bërë publike gjeolokalizohet në hartën e Bashkisë Shkodër e mbështetur mbi platformën Google Maps. Instrumenti azhurnohet vazhdimisht nga të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore në varësi të gjendjes (statusit) në të cilin ndodhen procedurat (planifikuar = ikonë gjeolokalizuese e kuqe, në proces = ikonë gjeolokalizuese e verdhë, apo realizuar = ikonë gjeolokalizuese e gjelbër), si dhe çdo 3-mujor raportohet në total me të ardhurat e mbledhura apo të transferuara dhe shpenzimet e realizuara. Ky instrument rezulton se vizitohet dhe monitorohet nga publiku përmes faqs zyrtare të internetit, dhe si i tillë duhet menduar të azhurnohet në një platformë mobile app që të mund të instalohej në smartphone-in apo tabletin dhe për çdo informacion të publikuar qytetarët informohen përmes mesazheve njoftuese të aplikacionit. Për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e këtij instrumenti edhe në të ardhmen, Bashkia Shkodër në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e implementimit të sistemeve të informacioneve të miratuara nga AKSHI, duhet të sigurojë mirëmbajtjen e pwr një periudhë minimalisht 3-vjeçare.							
ii. Synimi i projektit							
Informimi i publikut përi të dhënat e hapura (Open Data) mbi të ardhurat, shpenzimet e investimet si dhe llogaritjen e detyrimeve (taksat dhe tarifave vjetore) të Bashkisë Shkodër përmes Mobile App - Transparenca e Buxhetit.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Projektimi teknik i aplikacionit, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme dhe preventivimi.							
b) Rezultatet që prisni							
Aplikacion Mobile – Transparenca e Buxhetit i mundshëm për t'u shakruar, instaluar dhe azhurnuar në smartphone, tablet apo pajisje të tjera TIK të lëvizshme. Aplikacioni duhet të azhurnohet vazhdimisht dhe përmes mesazheve njoftuese të informojë të gjithë qytetarët e interesuar për të ardhurat që bashkia mbledh apo i transferohen në buxhet, shpenzimet dhe investimet që bëhen dhe fazën në të cilën ata ndodhen, mundësinë e sugjerimeve elektronike nga qytetarët si dhe atë të llogaritjes së detyrimeve (taksave dhe tarifave vjetore) familjare apo të çdo biznesi.							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit - Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) - Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qender			Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativë	Transferime	Kapitale
A.1	Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App	980				980	
	Shuma	980				980	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativë	Transferime	Kapitale

A.1	Mirëmbajtje e platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App	128			128		
	Shuma	128			128		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
